



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja (i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenet 16, 61 paragrafi 1.9 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 11 paragrafi 1 dhe nenit 17 paragrafi 1.10 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-400/03-0084071/22, të datës 29.09.2022, Për Miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2023 dhe Parashikimet Buxhetore 2024-2025, në implementimin e projektit Subvencionimi i Investimeve në Kapacitete Prodhuese të NMVM-ve, Vendimit të Kryetarit të Komunës nr.prot.02-400/01-0022116/23 të datës 24.03.2023, për lejimin e mjeteve financiare për subvencionimin e 16 bizneseve përfituese në Komunën e Podujevës, si dhe në rekomandim të datës 01.08.2023 të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0015276/23 datë 23.02.2023 për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, sipas Ftesës Publike nr.prot.15-300/01-0004082/23 të datës 13.01.2023, Kryetari i Komunës merr;

V E N D I M

Neni 1

S Sprint Sh.P.K., Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar – NUI 000000000, mbështetet me mjete financiare në shumë 4,050.00€.

Neni 2

Subvencionimi bëhet sipas Ftesës Publike nr.prot.15-300/01-0004082/23 të datës 13.01.2023, të publikuar nga Drejtoria Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, në emër të kompensimit të mjeteve financiare për sigurimin/ blerjen e pajisjeve nga ana e përfituesit me qëllim të implementimit të projektit Subvencionimi i Investimeve në Kapacitete Prodhuese të NMVM-ve.

Neni 3

Mbështetja financiare bëhet me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të bizneseve në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 4

Mjetet buxhetore sipas nenit 1 të këtij vendimi ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe përmes bankës barten në llogarinë e **S Sprint Sh.P.K.**

Neni 5

Zbatimin e Vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot, 02-400/03-0050625/23
Podujevë, datë, 02.08.2023



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr. prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr. prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, në kërkesë të datës 27.07.2023 të Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, i autorizuar për ushtrimin e funksionit nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Drejtorisë Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, merr:

V E N D I M

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas Ftesës Publike nr. prot.12-320/01-0046979/23 të datës 11.07.2023, në projektin “Përkrahje me Mëshqerra”, ngritet komisioni ad hoc në këtë përbërje:

- **Shefrie Gashi**, zyrtare në Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, kryesuese
- **Mimozë Restelica Sejdiu**, zyrtare në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, anëtare
- **Ymer Hoti**, udhëheqës i Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar

Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr. prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Anëtarëve të komisionit
Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
QSHQ/Arkivit

Nr. Prot. 02-020/04-0055847/23
Podujevë, datë, 02.08.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 1 dhe paragrafët 3.1 dhe 3.3, të Rregullores komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.por.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023 për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, sipas kërkesës nr.prot.06-400/03-0055859/23 të datës 02.08.2023, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj. Saranda Kadriu, nga Podujeva, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore të vajzës së saj Tuana Kadriu si dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve për trajtim mjekësor të saj, i jepet ndihmë financiare në shumë 1000.00 €.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e znj. Saranda kadriu.

Neni 3

Për zbatimin e vendimit e kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.

Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF.

QSHQ/Arkivit.

Znj. Saranda Kadriu (njoftohet përmes DSHMS-së)

Nr.Prot. 02-400/04-0056062/23
Podujevë, datë, 03.08.2023

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr. prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr. prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, në kërkesë të datës 04.08.2023 të Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, i autorizuar për ushtrimin e funksionit nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Drejtorisë Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, merr:

V E N D I M PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

1. Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas Ftesës Publike nr. prot.12-320/01-0042707/23 të datës 26.06.2023, për përkrahje në projektin Furnizim me Mekanizëm Bujqësor, ngritet komisioni në përbërje:

- **Hamide Aliu**, zyrtare për pylltari - DBPZHR, kryesuese
- **Behë Govori**, zyrtar për blektori, bletari dhe veterinari - DBPZHR, anëtar
- **Vahide Veseli**, zyrtare për zhvillim – DBPZHR, anëtare

2. Projekti realizohet në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me Agjencinë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA), sipas Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së cekur dhe Komunës së Podujevës me nr. prot. 02-016/01-0041642/23 datë 20.06.2023, Agjenci e cila gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave, do të ketë rolin monitorues, do të përcjell procesin e përzgjedhjes së përfituesëve.

Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr. prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Anëtarëve të komisionit

Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.


QSHQ/Arkivit

Nr. Prot. 02-020/04-0056755/23
Podujevë, datë, 04.08.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 17 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, në kërkesë nr.prot.04-422/01-0057653/23 të datës 08.08.2023 dhe sipas rekomandimit të datës 10 gusht 2023 të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0054227/22 datë 04.07.2022 i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z. Shkelzen Sinani, me vendbanim në fshatin Kërpimeh, Komuna e Podujevës për angazhimet dhe shpenzimet e bëra me rastin e promovimit të Komunës së Podujevës para donatorëve dhe investitorëve austriak, mbështetet me mjete financiare në shumë 200.00 €.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e z. Shkelzen Sinani.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

z. Shkelzen Sinani (njoftohet përmes DPZHE-së).

Nr.prot 02-400/03-0058665/23
Podujevë, datë, 11.08.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

znj. Ganimete Mahmuti, zyrtare e lartë e prokurimit , krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mbanë, **autorizohet** për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e Menaxherit të prokurimit në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të mbulimit të pozitës së cekur për shkak të shkuarjes së Menaxherit të prokurimit në pension dhe i njëjti vlen deri në rekrutimin e zyrtarit/es në pozitën e cekur komform rregullativës ligjore në fuqi, apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Administratës- DA dhe Zyra e Personelit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:
E Autorizuara
DA dhe Zyra e Personelit
QSHQ/Arkiva

Nr.prot. 02-020/05-0058743/23
Podujevë, datë: 11.08.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8 dhe 22 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-400/03-0084071/22, të datës 29.09.2022, për Miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2023 dhe Parashikimet Buxhetore 2024-2025, në implementimin e projektit "Furnizim i fermerëve me Mekanizëm Bujqësor në Komunën e Podujevës", në rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0056755/23 të datës 04.08.2023, për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas Ftesës Publike nr.prot.12-320/01-0042707/23, të 26.06.2023, në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit të lidhur mes Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA) dhe Komunës së Podujevës nr.prot.02-016/01-0041642/23 datë 20.06.2023, merr:

V E N D I M PËR MBËSHTETJEN E FERMERËVE ME MEKANIZËM BUJQËSOR NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Mbështeten pesëdhjetë (50) fermer përfitues nga Komuna e Podujevës, në projektin "Furnizim i fermerëve me mekanizëm bujqësor", në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pyltariisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR.

Neni 2

Mbështetja e fermerëve sipas nenit 1 të këtij vendimi bëhet me qëllim të zhvillimit dhe promovimit të kulturave bujqësore në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista e fermerëve të përzgjedhur për implementimin e projektit: "Furnizim i fermerëve me mekanizëm bujqësor", sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtorisë së Bujqësisë Pyltariisë dhe Zhvillimit Rural, Komisioni përkatës në bashkëpunim dhe koordinim me Agjencinë TIKA – në cilësinë e donatorit bashkëfinancues, në funksion të implementimit të projektit të cekur.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

DBPZHR

Komisionit me nr.prot.02-020/04-0056755/23 datë 04.08.2023

TIKA-s, (për njoftim) përmes DBPZHR

Nr.Prot. 02-320/01-0059055/23
Podujevë, datë: 11.08.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-020/01-0050862/18, jep këtë :

AUTORIZIM

Autorizohet z.Fatlum Osmani, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave në Komunën e Podujevës, të veprojë dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, derisa znj.Saranda Stublla, Drejtoreshë e Drejtorisë së cekur të kthehet nga pushimi, apo eventualisht deri në nxjerrjen e një akti tjetër.

Ky Autorizim vlen nga data 23.08.2023 deri më 29.08.2023.

Nr.prot.02-020/05-0062426/23
Podujevë, datë: 22-08-2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, sipas së projektit “Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2” (ReLOaD2), merr:

V E N D I M **PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR ANKESAVE NË PROJEKTIN ReLOaD2**

Neni 1

Formohet Komisioni i ankesave në kuadër të projektit “Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2” (ReLOaD2), në këtë përbërje:

Xhevdie Beqiri, kryesuese
Mimozë Restelica Sejdiu, anëtare

Florie Humolli, anëtare rezervë, në rast të paraqitjes së konfliktit të interesit.

Neni 2

Komisioni sipas nenit 1 të këtij Vendimi ka për detyrë që të merret me shqyrtimin e ankesave të projektit ReLOAD konform Marrëveshjes së nënshkruar në mes të Komunës së Podujevës dhe Projektit ReLOaD 2.

Neni 3


Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Vendimi nr. prot.02-020/04-0076447/22, datë 06.09. 2022.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Anëtarëve të Komisionit
QSHQ/Arkivës

Nr.prot. 02-020/04-0062782/23
Podujevë, datë: 23.08.2023



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenet 14 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, në funksion të krijimit të bazës për zbatimin e Sistemit Regjional të Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave në Regjionin e Prishtinës, sipas ftesës për Inicim të bashkëpunimit Ndërkomunal të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në emër të Ministrisë Federale Gjermane të Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik (BMZ), bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, merr:

VENDIM

**Për ndryshimin dhe plotësimin e
Vendimit nr.prot.02-020/04-0087945/22 të datës 13.10.2022**

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet përbërja e Ekipit Teknik për krijimin e bazës për zbatimin e Sistemit Regjional të Menaxhimit të Integruar të mbeturinave në Regjionin e Prishtinës, ngritur me Vendimin nr.prot.02-020/04-0087945/22 datë 13 tetor 2022, përkatësisht përbëja e Ekipit është:

Bahri Selimi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH
Leutrim Krasniqi, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM
Hamide Jashari, zyrtare e prokurimit 2, në Zyrën e Prokurimit
Hajriz Berisha, zyrtar i ambientit në DPUMM
Enis Sheholli, zyrtar i lartë ligjor në Zyrën ligjore
Alban Shabani, zyrtar për evidentimin e pronës së paluajtshme në DBF

Neni 2

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

u dërgohet:

Anëtarëve të Ekipit

QSHQ/Arkiva

Iniciuesit e bashkëpunimit ndër komunal-për njoftim

Nr.prot. 02-020/04-0063194/23
Podujevë, datë, 24.08.2023



Kryetari i Komunës
Shefqim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-020/01-0050862/18, jep këtë :

A U T O R I Z I M

Autorizohet z.Bahri Selimi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit në Komunën e Podujevës, të veprojë dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Administratës, derisa Drejtoresha e autorizuar për ushtrimin e këtij funksioni znj.Adelinë Stublla, të kthehet nga pushimi, apo eventualisht deri në nxjerrjen e një akti tjetër.

Ky Autorizim vlen nga data 28.08.2023 deri më 03.09.2023.

Nr.prot.02-020/05-0063855/23
Podujevë, datë: 28.08.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-020/01-0050862/18, jep këtë :

AUTORIZIM

Autorizohet z.Fatlum Osmani, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave në Komunën e Podujevës, të veprojë dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, derisa znj.Adelinë Stublla, Drejtoreshë e Drejtorisë së cekur të kthehet nga pushimi, apo eventualisht deri në nxjerrjen e një akti tjetër.

Ky Autorizim vlen nga data 28.08.2023 deri më 03.09.2023.

Nr.prot. 02-020/05-0063859/23
Podujevë, datë: 28.08.2023



Kryetari i Komunës
Shejtim Bulliqi